



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME



Asociación Ibero Americana
de Ministerios Públicos

Memorandum Mirëkuptimi

ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë (PP)

dhe Shoqatës Ibero-Amerikane e Ministrive Publike (AIAMP)

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, prokuroritë me juridikSION të përgjithshëm, referuar në vijim "PP", dhe

Shoqata Ibero-Amerikane e Ministrive Publike, referuar në vijim "AIAMP"

Në vijim referuar individualisht si "Pala" dhe së bashku si "Palët",

Duke pasur parasysh dispozitat e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si "Kushtetuta e Shqipërisë" dhe Ligjt nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në vijim referuar si "Ligji nr.97/2016" për përfaqësimin e prokurorisë në marrëdhënie me të tretët dhe ndihmën e ndërsjelltë në çështjet penale të juridikSIONIT të përgjithshëm, dhe në veçanti neni 148/b shkronja "dh" e Kushtetutës së Shqipërisë dhe neni 38, pika 2 shkronja "ë" dhe neni 2 shkronja "d" të ligjt nr. 97/2016;

Duke pasur parasysh Statutin e Shoqatës Ibero-Amerikane të Ministrive Publike të vitit 2017;

Duke shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunimin në luftën kundër krimeve ndërkufitar/ndërkombëtar që përfshijnë Palët, lidhur me trafikimet e paligjshme, pastrimin e parave ose çdo krim tjetër me interes të përbashkët për të dyja Palët, si dhe për përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe shkencore në fushën e të drejtës penale;

Duke u udhëhequr nga parimet e barazisë, mirëkuptimit të ndërsjellë dhe interesave reciproke, si dhe nxitjes së bashkëpunimit në çështjet me interes të përbashkët;

Me synimin krijimin dhe forcimin e lidhjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Palëve për të garantuar hetim dhe ndjekje penale efektive, në përputhje të plotë me aktet ndërkombëtare të njohura/ratifikuara dhe legjislacionin e brendshëm të Palëve, si dhe vënien para drejtësisë pa vonesë të personave që dyshohen ose akuzohen për kryerjen e krimeve në interes të përbashkët të Palëve;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Në kuadrin e juridikzionit dhe në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë dhe kuadrin ligjor e juridikzionet e secilit prej anëtarëve të AIAMP-ve, Palët do të forcojnë marrëdhëniet ndërinstitucionale në luftën kundër krimit ndërkufitar/ndërkombëtar të dy institucionet, duke përfshirë krimet e trafikimit të paligjshëm, pastrimit të parave ose çdo krim tjetër me interes të përbashkët për të dyja palët, si dhe përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe shkencore në fushën e të drejtës penale

Neni 2

Me qëllim të zbatimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi (në vijim:MM), pjesëmarrësit do të bashkëpunojnë në drejtimet/mënyrën e mëposhtme:

- Duke shkëmbyer informacion mbi sistemin ligjor dhe legjislacionin në fushën e luftës kundër kimeve ndërkufitare që përfshijnë Palët lidhur me trafikimet e paligjshme, pastrimin e parave ose çdo krim tjetër me interes të përbashkët për të dyja Palët, si dhe aktivitetet legjislative që lidhen me zbatimin e këtij MM, masat e veçanta të zbatimit të ligjit në fushat e juridikzionit të tyre dhe përvoja ndërkombëtare lidhur me krimet e lartpërmendura, duke përfshirë ekstradimet;
- Duke u këshilluar për çështje të përgjithshme ligjore që lidhen me ndihmën e ndërsjellë juridikionale, përfshirë ekstradimet;
- Duke organizuar vizita të ndërsjella të ekspertëve me qëllim përmirësimim e njohurive, përvojës dhe forcimit të aftësive të pjesëmarrësve, përfshirë mundësinë e organizimit të vizitave studimore dhe pune.
- Duke marrë pjesë në aktivitete specifike të AIAMP për promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet PP shqiptare dhe Prokurorive Publike anëtare të AIAMP-së, si dhe të zhvillojnë strategji të përbashkëta (të zakonshme) që i lejojnë Palët të përmirësojnë kapacitetet institucionale për të përballuar çështje kriminale komplekse.
- Duke marrë pjesë në rrjete dhe grupe pune për çështje specifike me qëllim shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Neni 3

Palët do të mbajnë kontakte dhe marrëdhënie ekspertësh ndërmjet zyrtarëve të tyre me qëllim që të përditësojnë në mënyrë efektive përvojat e tyre dhe të shkëmbejnë informacione dhe të dhëna mbi legjislacionin e vendeve të tyre, të cilat, në veçanti, kanë të bëjnë me shkëmbimin e teksteve

të ligjeve dhe rregulloreve, materialeve analitike, statistikave dhe raportet për shtypjen/goditjen e krimeve ndërkufitar që përfshijnë Palët, lidhur me trafikimet e paligjshme, pastrimin e parave dhe/ose çdo krim tjetër me interes të përbashkët për të dyja Palët.

Neni 4

Me qëllimin e zbatimit të këtij MM, Palët do të kontaktojnë njëri-tjetrin drejtpërdrejt nëpërmjet mjeteve të komunikimit që ata i konsiderojnë të përshtatshme.

Për kontakte të drejtpërdrejta, pjesëmarrësit do të përdorin adresat e pikave të kontaktit të Palëve dhe mjetet e komunikimit si më poshtë:

-Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë cakton Drejtorinë e Marrëdhënieve JuridikSIONALE me Jashtë në PP, si pikë kontakti për qëllimet e këtij Memorandumi:

Adresa: Rruga: Rruga "Qemal Stafa", Nr.1, Tiranë

E-mail: Ols.Dado@pp.gov.al

-Shoqata Ibero-Amerikane e Prokurorive Publike cakton Sekretariatin e Përgjithshëm të saj si pikë kontakti për qëllimet e këtij Memorandumi:

Adresa: : Ortega y Gasset Street n.57 (*International Cooperation Unit
Spanish General Prosecution Office*)
28072 Madrid (Spain)

Email: aiamp.secretariageneral@fiscal.es

Neni 5

Palët do të informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim të zyrtarëve të caktuar pika kontakti sipas nenit 4 të këtij Memorandumi.

Neni 6

Palët do të zbatojnë këtë MM në përputhje me aftësitë e tyre buxhetore dhe organizative.

Palët nuk do të kërkojnë rimbursimin e shpenzimeve që rrjedhin nga zbatimi i këtij Memorandumi, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe reciprokisht në secilin rast specifik.

Neni 7

Të dhënat dhe/ose informacionet e shkëmbyera sipas këtij MM do të përdoren ekzkluzivisht për qëllimet e parashikuara në MM. Pala që merr të dhënat nuk do ti përdor ato për ndonjë qëllim tjetër dhe nuk do tua transmetojë subjekteve të tjera pa autorizimin paraprak me shkrim nga tjetri.

Palët do të marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale që do të përpunohen brenda këtij MM, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale të vendeve përkatëse.

Shkëmbimi i të dhënave personale ndërmjet palëve sipas këtij MM do të kryhet vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) në mbrojtje të një interes kyç të personit në fjalë ose të një personi tjetër fizik;
- b) në mbrojtje të interesave legjitime të personit në fjalë, siç parashikohet nga ligji i Palës mbështetëse;
- c) parandalimi i një kërcënimi të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike të palëve ose të një vendi të tretë;
- d) në raste specifike, me qëllim parandalimi, hetimi dhe ndjekjen penale të krimeve dhe zbatimin e sanksioneve penale në Palen mbështetëse, ose me synim për të krijuar, ushtruar ose mbrojtur një të drejtë përpara autoriteteve gjyqësore kompetente në lidhje me synimet e përmendura mësipër.

Neni 8

Ky MM nuk krijon për Palët të drejta dhe detyrime të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare publike dhe as nuk cenon të drejtat ose detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse në të cilat Republika e Shqipërisë dhe vendet anëtare të AIAMP janë palë.

Neni 9

Ky MM do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij dhe do të mbetet i vlefshëm për një periudhë të pacaktuar kohore.

Ky MM mund të ndryshohet në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve.

Secila Palë mund të përfundojë këtë MM duke i dhënë një njoftim me shkrim Palës tjetër. Në rast të tillë, ky Memorandum do të pushojë së qeni në fuqi tre muaj pas datës në të cilën pjesëmarrësi tjetër ka marrë njoftimin për përfundimin.

Neni 10

Ky Memorandum Mirëkuptimi është nënshkruar në tre kopje identike në shqip, spanjisht dhe anglisht.

Në rast të dallimeve në interpretim, teksti në gjuhen angleze do të mbizotërojë.

Nënshkruar në Kartagjena, Kolumbi/ dhe në Tiranë, Republika e Shqipërisë me 29/ 07/ 2022

Për PP,

Olsian ÇELA
Prokurori i Përgjithshëm
Republika e Shqipërisë

Për AIAMP,

Jorge Abbott Charme
Presidenti në largim
Prokuroria e Përgjithshme Kombëtare
Republika e Kilit

Për AIAMP,

Francisco Barbosa Delgado
Presidenti në vazdim
Prokuroria e Përgjithshme e Kombit
Republika e Kolumbisë